

Të nderuara kolege, studiuese dhe mike

Të nderuara përfaqësuese të institucioneve

Është një nderë që sot, në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në bashkëpunim me UN Women, jemi mbledhur për të diskutuar një temë që është njëkohësisht akademike, shoqërore dhe zhvillimore: "Avancimin e grave dhe i vajzave në shkencë dhe akademi në Kosovë". Kjo tryezë nuk është thjesht një aktivitet formal. Ajo është një thirrje për reflektim të thellë institucional dhe një angazhim i përbashkët për veprim konkret.

Në këtë tryezë kemi bashkuar zëra të rëndësishëm: vajza dhe gra në shkencë, profesoresha, si dhe përfaqësuese të shoqërisë civile, të cilat që nga vitet '90 kanë qenë shtyllë e rezistencës dhe ndërtimit të shoqërisë sonë. Kontributi i tyre në arsim, trajnime dhe fuqizim të grave është themelor dhe meriton të njihet më shumë edhe në nivel institucional.

Të nderuara kolege

Secila nga ju përfaqëson një histori sukse, por edhe një potencial për ndikim më të madh. Dhe pikërisht ky potencial duhet të kthehet në ndikim konkret – në politika, në vendimmarrje dhe në zhvillimin e vendit. Prandaj, të dashura mike, jemi këtu para së gjithash për të shprehur mirënjohjen tonë për të gjitha institucionet, individët dhe shoqërinë civile që kanë kontribuar në këtë rrugëtim të rëndësishëm. Por sot, ne duhet të shkojmë një hap më tej. Kemi nevojë për politika të qarta dhe të matshme, në mënyrë që fuqizimi i grave në shkencë të mos mbetet vetëm pjesë e diskursit publik, por të përkthehet në veprime konkrete, buxhete të dedikuara dhe përgjegjësi institucionale. Në këto takime duhet të përfshijmë jo vetëm elitën akademike, krijueset dhe artistet, por edhe gjeneratat e reja – vajzat që sot janë studente dhe që nesër do të jenë bartëse të zhvillimit shkencor. Edhe pse gratë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të studentëve dhe të diplomuarve në arsimin e lartë, ato vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara në gradat më të larta akademike, në pozita udhëheqëse dhe veçanërisht në fushat e STEM – shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë. Këto fusha përbëjnë bazën e zhvillimit ekonomik dhe teknologjik të shoqërive moderne. Prandaj, avancimi i grave në këto disiplina nuk është vetëm çështje e barazisë gjinore, por edhe një parakusht për zhvillim të qëndrueshëm dhe inovacion.

Kur flasim për përparimin e grave në Kosovë, shpesh theksojmë sukseset – dhe me të drejtë. Por një analizë e sinqertë kërkon që të shohim edhe boshllëqet që ende ekzistojnë. Në mbi 25 vite të ndërtimit të shtetit, gratë kanë arritur të depërtojnë në disa pozita të rëndësishme. Megjithatë, përfaqësimi i tyre në nivelet më të larta të vendimmarrjes mbetet i kufizuar, veçanërisht në akademi dhe në institucionet e dijes. Këtu shfaqet një paradoks: Kosova ka krijuar shembuj simbolikë të lidërshiptit të grave në nivel shtetëror, por në universitete, akademi dhe struktura politike, gratë vazhdojnë të jenë dukshëm më pak të përfaqësuara. Këto nuk janë vetëm statistika. Janë tregues të një sfide strukturore: talenti dhe potenciali ekzistojnë, por rruga drejt lidërshiptit ende nuk është plotësisht e hapur.

Prandaj, sfida jonë nuk është vetëm rritja e numrit të grave në sistem. Sfida jonë është hapja reale e rrugës drejt vendimmarrjes dhe lidërshiptit të tyre.

Pyetja thelbësore sot nuk është vetëm: Sa gra janë pjesë e sistemit? Por: Sa gra janë pjesë e vendimmarrjes reale?

Sepse përfshirja e grave nuk është vetëm çështje përfaqësimi – është çështje e cilësisë së demokracisë, zhvillimit të qëndrueshëm dhe përdorimit të plotë të kapitalit njerëzor. Në nivelin akademik, sfidat janë konkrete. Në Universitetin e Prishtinës, deri më sot, asnjë grua nuk ka

ushtuar detyrën e rektorit. Numri i dekanëve zakonisht ka qenë vetëm 2 deri në 3 nga 14 fakultete. Në thirrjet më të larta akademike, gratë përfaqësojnë rreth 30–35%, ndërsa në stafin akademik rreth 40%. Megjithatë, në pozitat udhëheqëse akademike, përfaqësimi i tyre bie në rreth 25%. Kjo tregon qartë se edhe aty ku gratë janë të pranishme në numër, rruga drejt lidërshiptit mbetet më e vështirë. Edhe të dhënat për pjesëmarrjen në fusha shkencore tregojnë një realitet me dy dimensione.

Gratë përbëjnë shumicën e studentëve në universitete – rreth 55–60%, por ky përfaqësim nuk shpërndahet në mënyrë të barabartë. Në shkencat natyrore të avancuara: 15–20%, Në inxhinieri dhe teknologji: rreth 15%, Në shkencat shoqërore: 55–60%, Në mjekësi dhe shkenca biologjike: 45–50%, Në ekonomi: rreth 35%, Në art dhe dizajn: rreth 50%.

Prandaj, nëse duam një shoqëri më inovative dhe konkurruese, duhet të krijojmë politika dhe mekanizma që inkurajojnë vajzat dhe gratë, duke investuar në: mentorim, modele frymëzuese, rrjete profesionale, përfshirje në projekte ndërkombëtare, politika afirmative dhe mbështetje financiare për kërkimin shkencor.

Të nderuara kolege dhe studiuese,

Vajzat tona sot studiojnë, diplomojnë dhe shkëlqejnë. Por pyetja mbetet: A po përkthehet ky sukses në punësim real? Të dhënat tregojnë një paradoks: rreth 30–40% e grave në fushat shkencore nuk punojnë në profesionin e tyre, ndërsa në rajon 25–35% e vajzave me diploma shkencore janë të papuna ose të nën-punësuar. Kjo është një humbje e drejtpërdrejtë e potencialit tonë. Ky hendek është më i dukshëm në inxhinieri, teknologji dhe kërkim shkencor – jo për shkak të mungesës së aftësisë, por për shkak të mungesës së mundësive. Sot nuk kemi mungesë të vajzave në shkencë – kemi mungesë të hapësirës për to.

Kur flasim për zhvillim dhe inovacion, flasim për investim në kërkim dhe zhvillim (R&D). Në Kosovë, këto shpenzime janë rreth 0.1% e PBB-së. Në BE, mesatarja është mbi 2.2%, ndërsa në vendet më të avancuara kalon 3%. Kjo ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e universiteteve, inovacionin, ekonominë dhe largimin e trurit. Sepse investimi në shkencë nuk është shpenzim – është investimi më i sigurt në të ardhmen.

Të nderuara mike, Në fund, dua të ndalem te ajo që qëndron pas të gjitha këtyre: te potenciali dhe e ardhmja. Çdo vajzë që hyn në një klasë apo laborator nuk kërkon vetëm një diplomë – ajo kërkon një mundësi, një hapësirë, një zë. Dhe pyetja është: A jemi duke ia hapur këtë rrugë? Sepse talenti nuk mungon. Dija nuk mungon. Ajo që shpesh mungon është mbështetja dhe dera e hapur në momentin e duhur.

Ky takim nuk duhet të mbetet vetëm diskutim. Ai duhet të kthehet në një mekanizëm të qëndrueshëm për politika më efektive. Prandaj propozoj që kjo tryezë të institucionalizohet si një platformë e rregullt vjetore bashkëpunimi, ku do të shkëmbejmë praktika, do të hartojmë rekomandime konkrete dhe do të ndërtojmë partneritete funksionale. Le ta konsiderojmë këtë si hapin e parë drejt një bashkëpunimi të strukturuar dhe me përgjegjësi të përbashkët.

Ju falënderoj për pjesëmarrje, angazhimin dhe kontributin tuaj.

Akademike Justina Shiroka-Pula

Prishtinë, 31.03.2026